



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 11.11.2020

**Lënda:** Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 11.11.2020, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit z. Elvin Gokaj, konfirmuar në detyrë me vendimin nr. 187, datë 24.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha shkaqet e ankimit, prapësimet e palëve dhe provat e administruara, Komisioneri Publik, në përfundim, duke u përmbajtur parashtrimeve të paraqitura në këtë gjykim, konstaton se pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e secilit shkak ankimi.

Nga vlerësimi tërësor i akteve të administruara në gjykimin e kësaj çështjeje nga ana e këtij trupi gjykues, Komisioneri Publik çmon se të gjitha shkaqet e ankimit të ushtruar kundër vendimit të Komisionit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, mbeten për t'u shqyrtuar dhe vendosur mbi to nga ana juaj.

Për Komisionerin Publik, shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje nga ana juaj, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, bazuar në nenin 179/b, pika 5, të Kushtetutës, nenin C, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, provoi se:

**Për sa i përket kriterit të pasurisë:**

**1.** Për pasurinë nr. 1, “Apartament banimi me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>”, ndodhur në Durrës, dhe kështet e pagesave të kryera

**1.1** Në lidhje me shkakun e ankimit, mbi pagesën e kështit të parë për këtë pasuri, Komisioneri Publik, bazuar në verifikimin e akteve në dispozicion dhe, pasi analizoi parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në datën 6.10.2020, 6.11.2020 dhe shpjegimet përkatëse, vlerëson se:

- (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë të apartamentit;
- (ii) subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve nga të ardhura të ligjshme në shumën - 838.738 (tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lekë, për pagesën e këstit të parë të apartamentit.

**1.2** Lidhur me pagesën e këstit të dytë, në vlerën 10.000 (dhjetë mijë) euro, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë, në deklaratën “Vetting”, burimin për pagesën e këstit të dytë të apartamentit, pasi në momentin e plotësimit të deklaratës “Vetting”, ka pasur detyrimin të plotësonte të dhënat për çdo pasuri në pronësi, të shpjegonte dhe të provonte bindshëm lidhur me burimin e krijimit të saj, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016.

**1.3** Në përfundim, për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme dhe ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

## **2 Lidhur me llogaritë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, pranë Bankës \*\*\*, si dhe llogaritë dyemërore, të padeklaruara nga subjekti i rivlerësimit**

**2.1** Komisioneri Publik, bazuar në aktet e administruara në dosje në lidhje me depozitën bankare të bashkëshortes, pranë Bankës \*\*\*, me nr. llogarie: “\*\*\*\*”, ka konstatuar se:

(i) Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka përfituar interesat nga depozitat dyemërore;<sup>1</sup> (ii) rezultojnë kalime fondesh nga llogaria personale e bashkëshortes së subjektit në llogarinë dyemërore dhe anasjelltas; (iii) bashkëshortja e subjektit në këto llogari bankare dyemërore rezulton të jetë në cilësinë e depozituesit/titullare e llogarive bankare.

Lidhur me sa më sipër trajtuar, ndryshe nga sa ka pretenduar subjekti në parashtrimet<sup>2</sup> e tij, kjo depozitë është shtuar me interesa të gjeneruara nga depozita dyemërore.

### **Llogaritë bankare të përbashkëta, dyemërore, të padeklaruara**

**2.2** Referuar akteve në dosjen e Komisionit<sup>3</sup>, është konstatuar se, në periudhën 2010 - 2016, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. \*\*\*.\*\*\*, ka pasur disa llogari të përbashkëta dyemërore me znj. \*\*\*.\*\*\* (nëna e bashkëshortes) dhe \*\*\*.\*\*\* (nëna e subjektit) si vijon:

**2.2.1** *Depozitë dyemërore në emër të \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\**, në vlerën 15.599 (pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë) euro, në datën \*\*\*.12.2015. Kjo shumë është krijuar nëpërmjet: një depozitimi *cash* në shumën 5.400 (pesë mijë e katërqind) euro, në datën \*\*\*.8.2010; një depozitimi *cash* në shumën 4.000 (katër mijë) euro, në datën \*\*\*.1.2012 dhe një depozitimi *cash* në shumën 5.000 (pesë mijë) euro, në datën \*\*\*.8.2013, të cilat, së bashku me interesat bankare, kanë arritur shumën totale 15.599 (pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë) euro.

<sup>1</sup> Referuar transaksionit të kryer nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, të datës \*\*\* – \*\*\*.5.2013, në llogarinë \*\*\*, në \*\*\* Bank.

<sup>2</sup> Referuar parashtrimeve të datës 6.10.2020, faqe 9, paragrafi i parafundit, dhe parashtrimeve të datës 6.11.2020, faqe 5, paragrafi 3.

<sup>3</sup> Referohuni informacionit të dërguar nga \*\*\* Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2018.

**2.2.2** *Depozitë dyemërore në emër të \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\**, në vlerën 15.160 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) euro, në datën \*\*\*.12.2015. Kjo shumë është krijuar nëpërmjet: një depozitimi *cash*, në shumën 10.003 (dhjetë mijë e tre) euro, në datën \*\*\*.1.2012 dhe një depozitimi *cash* në shumën 5.000 (pesë mijë) euro, në datën \*\*\*.1.2015.

**2.2.3** *Depozitë dyemërore në emër të \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\**, në shumën 1.001.900 lekë, në datën \*\*\*.12.2015. Bashkëshortja e subjektit ka krijuar një depozitë dyemërore pranë \*\*\* Bank, në datën \*\*\*.12.2012, me nënën e saj, znj. \*\*\*.\*\*\*, në shumën 1.000.004 (një milion e katër) lekë. Pas maturimit të kësaj depozite rezulton se është tërhequr *cash* nga \*\*\*.\*\*\*, në datën \*\*\*.6.2013, shuma 990.000 (nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë dhe vetëm dy ditë më pas, në datën \*\*\*.6.2013, është depozituar *cash* shuma 1.000.000 (një milion) lekë, dhe në vijim ka kaluar në depozitë dyemërore në emër të \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*.

**2.3** Lidhur me këto depozita dyemërore bazuar: (i) në kontratat e depozitave bankare, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është në cilësinë e “titullares së llogarisë/depozitues”; (ii) në nenin 199, paragrafi i dytë i Kodit Civil, ku parashikohet se: “*Pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta*”, pra pjesa takuese e znj. \*\*\*.\*\*\* në këto depozita është 50% e tyre; (iii) në transaksionet e kryera në këto llogari bankare, Komisioneri Publik vlerëson se, nga përfshirja në analizën financiare vjetore të pjesës takuese 50 % të bashkëshortes në këto depozita bankare, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e krijuara për periudhën 2010 - 2016, me diferencë negative – 1.999.397 lekë.

**2.4** Në zbatim të kërkesës së trupit gjykues të Kolegjit, miratuar me vendim të ndërmjetëm të seancës së datës 6.11.2020, lidhur me shkaqet e ankimit dhe në funksion të qartësimit të tyre, lidhur me depozitat dyemërore, Komisioneri Publik përgatiti analizën mbi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, deri në datën e krijimit të depozitave dyemërore, Komisioneri Publik kreu analizën financiare,<sup>4</sup> nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me burime nga të ardhura të ligjshme (50% pjesë takuese) depozitat dyemërore në datat e krijimit të tyre, për një diferencë negative prej - 2,345,270 lekë.

**2.5** Për sa më sipër, në lidhje me këto llogari bankare dyemërore, Komisioneri Publik, edhe pasi analizoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, konkludon se:

(i) Subjekti dhe bashkëshortja e tij në DV-të respektive nuk kanë deklaruar depozitat dyemërore, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, “Mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”.

(ii) Subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me burime nga të ardhura të ligjshme pjesën takuese 50%, të depozituar në këto llogari dyemërore.

**2.6** Në këto kushte, në lidhje me depozitat dyemërore, Komisioneri Publik konkludon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, ka mungesë të burimeve financiare të

---

<sup>4</sup> Dorëzuar në Kolegj në datën 9 nëntor 2020.

ligjshme dhe ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016.

### **Kërkimi përfundimtar i ankimit**

Në përfundim të këtyre parashtrimeve, Komisioneri Publik vlerëson se:

- Në konsideratë të shkaqeve të ankimit, Komisioneri Publik, bazuar në kërkesat e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë e deklaruar dhe likuiditetet, rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.
- Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve D, Ç dhe F të aneksit të Kushtetutës, të nenit 4, pika 2, si dhe nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, përfundimisht, kërkohmë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit:

Ndryshimin e vendimit nr. 187, datë 24.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, zotin Elvin Gokaj dhe shkarkimin e subjektit nga detyra.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Darjel SINA**